

VENDIM
Nr.219, datë 28.1.2008

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT NGA POSTA SHQIPTARE SHA DHE SHËRBIMI KONSULLOR, NË ZBATIM TË LIGJIT NR.9831, DATË 12.11.2007 “PËR DËMSHPËRBLIMIN E ISH-TË DËNUARVE POLITIKË, TË REGJIMIT KOMUNIST”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë, të regjimit komunist”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë, të regjimit komunist”, të zbatohen këto tarifa shërbimi:

a) Nga Posta Shqiptare sh.a.:

i) për qytetin e Tiranës, 70 lekë, për aplikim;

ii) për qytetet dhe zonat jashtë Tiranës, 100 lekë, për aplikim.

b) Nga shërbimi konsullor i Republikës së Shqipërisë 15 euro, për aplikim.

2. Formularët tip të aplikimit, që do të plotësohen nga aplikuesit, dërgohen nga Ministria e Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha